REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4228/2 Prot Rrëshen, më 01 . 10 . 2026

V E N D I M

Nr. 82 datë 25. 09. 2026
PËR
"MIRATIMIN, PËRDORIM FOND EMERGJENCAVE CIVILE NGA BUXHETI I BASHKISË, VITIT 2026", BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", ligji nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", Udhëzimin nr. 9, datë 20. 07. 2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", Vendimin nr. 98, datë 10.12.2025, të Këshillit Bashkiak Mirditë, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", Kërkesës nr. 3723 prot, datë 14.08.2026 të Agjencisë Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes, "Për akordim fondi për riparimin e makinës Teknologjike tip Volvo", *Relacion për përdorim fond emergjencave civile nga buxheti i bashkisë, nr. 4228 prot, datë 18.09.2026* dhe *preventivi i objektit,* së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 23.09.2026, të Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit,* për t'ia kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorim fond emergjencave civile nga buxheti i vitit 2026 (buxhet bashkie), si më poshtë;
   a) **Paksim** zërin e buxhetit; Fondi i emrgjencave civile (buxh.bashkie), me kodet e buxhetit si vijon;
   133 00 2133001 01 231 AC133 V091AAB;.....**100 000** lekë
   133 00 2133001 01 604 AC133 V091AAB;..... **1 500 000** lekë

   a) **Shtesë** fondi në zërin e buxhetit: Riparim i makinës Teknologjike, tip. Volvo të APPM në kodet e buxhetit si vijon;
   133 00 2133006 01 602 AB133 V510AAE;.....**1 600 000** lekë

2. Relacioni për përdorim fond emergjencave civile nga buxheti i bashkisë, nr. 4228 prot, datë 18.09.2026, bashkëlidhur, *pjesë përbërse e këtij vendimi*

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria e Financë dhe Buxhetit & Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes APPM-M)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

S E K R E T A R
Gaspër TOPOLLAJ

K R Y E T A R
Aleksandër PICAKU

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al
ADRESA: SHESHI "ADEM JASHARI" RRESHEN
Tel/dhe fax: (00355) (0) 2162233
www.bashkiamirdite.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

P/V E N D I M
Nr.85 date 18.9.2026

Nr4228/1 prot Rreshen me 18/09/2026

"PËR PËRDORIM FOND EMERGJENCAVE CIVILE, BUXHET BASHKIE"

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr.45/2019 "Per mbrojtjen civile", 87/2025, "Per buxhetin e vitit 2026", "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", ne VKB nr.98 datë 10.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", relacionin nr.3723 prot, date.14.08.2026, e APPM, "Kerkese per akordim fondi per riparimin e makines teknologjike tip VOLVO" , Këshilli i Bashkisë Mirditë, pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkise;

V E N D O S I:

1. Të miratojë perdorimin nga fondi i emergjencave civile,(buxheti I bashkise) si me poshte.:

   a-Paksim zerin e buxheti "fondit te emergjencave civile(buxheti I bashkise)",me kodet e buxhetit si me poshte:

   133 00 2133001 01 231 AC133 V091AAB.....100 000 leke
   133 00 2133001 01 604 AC133 V091AAB.....1 500 000 leke

   b-Shtese fondi ne zerin e buxhetit: "Riparim i makines telnologjike, tip volvo te APPM, ne kodet e buxhetit si me poshte:

   133 00 2133006 01 602 AB133 V510AAE..... 1 600 000 leke

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETARI **KRYETARI**

Gaspër TOPOLLAJ **Aleksander PICAKU**

Paraqiten projektin

Dr. AIKE: F.Vorfi

Dr./finances/buxhetit:: V.Gjoka

Pergj sekt juridik/prok: L.Gjergji

KRYETARI
Albert MËLYSHI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.a

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
AGJENCIA E PUNËVE PUBLIKE DHE MIRËMBAJTJES

Nr. 4228 Prot Rrëshen me 18.03.2026

RELACION
PËR
PROJEKT VENDIMIN
PËR
« PËRDORIM FONDI I EMERGJENCAVE CIVILE , BUXHETI BASHKISË «

TË NDERUAR KËSHILLTARË :

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore në RSh-së", Ligjin Nr.10 296 datë 08.0702010 " Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Ne si Agjensi e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes, për shkak të përgjegjësisë sonë për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane kudo në territorin e Bashkisë Mirditë, kërkojmë nga ana juaj akordimin e fondit të nevojshëm për riparimin e një prej makinave teknologjike të pastrimit të tipit VOLVO.

Ky mjet aktualisht ka pësuar një defekt të rëndë në impjantin elektrik , dhe është bërë pothuajse e pamundur që mbetjet urbane në territorin e Bashkisë Mirditë të menaxhohen në kohën e duhur vetëm me një mjet në funksion.

Në këto kushte , për të shmangur ndërprerjen e shërbimit dhe për të garantuar grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane , bëhet e domosdoshme dhe emergjente riparimin i mjetit Makinë Teknologjike tip VOLVO.
Nevoja për këtë ndërhyrje është urgjente dhe lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e standarteve të shërbimit publik.

Konkretisht problematikat që e bëjnë të domosdoshme këtë ndërhyrje janë :

8. Pamundësia aktuale për të kryer shërbimin e rregullt të grumbullimit dhe trasportit të mbetjeve urbane për shkak të mosfunksionimit të të dy mjeteve .
9. Rreziku i ndërprerjes së plotë të shërbimit në territor.
10. Akumulimi i mbetjeve urbane në pikat e grumbullimit.
11. Rritja e rrezikut për krijimin e problematikave higjeno-sanitare.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

12. Rritja e rrezikut për burim infeksionesh për shkak dhe të temperaturave të larta .
13. Rritja e nivelit të ndotjes si pasojë e mos grumbullimit të mbetjeve , si edhe përhapja e insekteve , brejtësve ose organizmave të tjerë që vënë në rrezik edhe shëndetin e banorëve.
14. Mundësia për të qënë burim zjarresh.

Nga sa më sipër, duke vlerësuar rëndësinë jetike të këtij shërbimi për komunitetin , kërkohet miratimi i fondit të nevojshëm për riparimin dhe vënien në funksion të mjetit teknologjik , me qëllim vijimin e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane, punë e cila është një nga shërbimet më të rëndësishme që Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes - Mirditë kryen për komunitetin dhe territorin e Bashkisë Mirditë.

Duke marrë për bazë vlerësimin e cmimeve në tregun aktual të serviseve të riparimit të automjeteve kërkojmë akordimin e një fondi prej 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë.

Duke ju Falenderuar për Mirëkuptimin !

DREJTORI
Kastriot CAKA

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISË
Albert MËLYSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-BASHKIA MIRDITË

Nr.3723 Prot
Datë 14.08.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
AGJENCIA E PUNËVE PUBLIKE DHE MIRËMBAJTJES

Nr. 767 Prot Rrëshen me 12 . 08 .2026

Lënda : Kërkesë për akordim fondi për riparim të Makinës Teknologjike tip VOLVO
Drejtuar : Kryetarit të Bashkisë Mirdite

Z. Albert Mëlyshi

Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit – Bashkia Mirditë
Drejtorisë Juridike, Prokurimeve Publike dhe Mardhënieve me Qytetarët

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore në RSh-së", Ligjin Nr.10 296 datë 08.0702010 " Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Ne si Agjensi e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes, për shkak të përgjegjësisë sonë për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane kudo ne territorin e bashkisë mirditë, kërkojme nga ana juaj akordimin e fondit të nevojshëm për riparimin e një prej makinave teknologjike të pasrimit të tipit VOLVO.

Ky mjet aktualisht ka pësuar një defekt të rëndë në impjantin elektrik, dhe është bërë pothuajse e pamundur që mbetjet urbane në territorin e Bashkisë Mirditë të menaxhohen në kohën e duhur vetëm me një mjet nw funksion.

Në këto kushte, për të shmangur ndërprerjen e shërbimit dhe për te garantuar grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane, bëhet e domosdoshme dhe emergjente riparimin i mjetit Makine Teknologjike tip VOLVO
Nevoja për kete ndërhyrje është urgjente dhe lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e standarteve te sherbimit publik.

Konkretisht problematikat që e bëjnë të domosdoshme këtë ndërhyrje janë :

1. Pamundësia aktuale për të kryer shërbimin e rregullt të grumbullimit dhe trasportit të mbetjeve urbane për shkak të mosfunksionimit të të dy mjeteve
2. Rreziku i ndërprerjes së plotë të shërbimit në territor
3. Akumulimi i mbetjeve urbane në pikat e grumbullimit
4. Rritja e rrezikut për krijimin e problematikave higjeno-sanitare
5. Rritja e rrezikut për burim infeksionesh për shkak dhe të temperaturave të larta

5. Rritja e rrezikut për burim infeksionesh për shkak dhe të temperaturave të larta
6. Rritja e nivelit të ndotjes si pasojë e mos grumbullimit të mbetjeve, si edhe perhapja e insekteve, brejtësve ose organismave të tjerë që vënë në rrezik edhe shendetin e banorëve
7. Mundësia për të qënë burim zjarresh

Nga sa më sipër, duke vlerësuar rëndësinë jetike të këtij shërbimi për komunitetin, kërkohet miratimi i fondit të nevojshëm për riparimin dhe vënien në funksion të mjetit teknologjik, me qëllim vijimin e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane, punë e cila është një nga shërbimet më të rëndësishme që Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes - Mirditë kryen për komunitetin dhe territorin e Bashkisë Mirditë.

Duke marrë për bazë vlerësimin e cmimeve në tregun aktual të serviseve të riparimit të automjeteve kërkojmë akordimin e një fondi prej 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë.

Duke ju Falenderuar për Mirëkuptimin !

Përgjegjësi i Sektorit të Pastrimit, Gjelbërimit
dhe
Mirëmbajtjes së Varrezave

Tonin Gjonaj

DREJTORI I AGJENCISË SË
PUNËVE PUBLIKE DHE MIRËMBAJTJES

Kastriot CAKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË - AGJENSIA E PUNËVE PUBLIKE DHE MIRËMBAJTJES - APPM

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al